



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 19, datë 29.05.2023

PËR

**MBI KORRIGJIMIN E GABIMIT NË VENDIMIN NR. 3, DATË
31.05.2018 PËR MIRATIMIN E LEJES "PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR", PËR PRODHIM HIDROENERGJIE, PËR HEC "BLAC"
SUBJEKTI BLAC ENERGY SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", si dhe referuar nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative "**Korrigjimi i gabimeve materialeve në aktin administrativ**" 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njëhësuar të tij. Në këto kushte: Me kërkesë të subjektit dhe me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore pasi u konstatua se kërkesa e subjektit qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujor Erzen,

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e gabimit material në "leje për përdorim burimi ujor për prodhim hidroenergjie, subjekti "BLAC ENERGY" SH.P.K Në periudhën e vlefshmërisë: Nga 31/05/2018 - 30/05/2023 në "Sipas afatit të koncesionit".

2. Asnjë trgues tjetër nuk ndryshon përvec gabimit material (Nga 31/05/2018 - 30/05/2023 në “Sipas afatit të koncensionit”.)
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

